



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 05**

**Datë: 01. 03. 2023. Ora: 13:30**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

#### **1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

- Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes 04/2023

#### **2. Aktivitetet e SKQZ-së**

#### **3. Aktivitetet e ZRCKFSP**

- Raport për azhurnimet vjetore të partive politike të regjistruara, 31 janar 2023.

#### **4. Raportet e Këshillave të KQZ-së**

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Projektit dhe Agjendës për “Punëtori në mes zyrtarëve komunal të zgjedhjeve dhe KQZ-së për planin e punës së KQZ-së për vitin 2023 dhe zbatimin e tij”,
- Shqyrtimi dhe miratimi i listës së Qendrave të Votimit,
- Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave për distinktiv ID-Bexha dhe
- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit mbi realizimin e projektit Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinj për Zgjedhje.

- **Këshilli për Buxhet dhe Financa**

- Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të planit të buxhetit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave Zveçan dhe Leposaviq 23 prill 2023.

- **Këshilli për personel**

- Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të planit të angazhimit të stafit jo permanent për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave Zveçan dhe Leposaviq 23 prill 2023.

## 5. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullave Zgjedhore

## 6. Të ndryshme

---

### 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Në fillim të kësaj mbledhje, në emër të KQZ kryetari Kreshnik Radoniqi i uroi mirëseardhje anëtarit të ri të KQZ-së, Alban Krasniqi nga subjekti politik Lëvizja “Vetëvendosje!” i cili, e zëvendëson anëtarin e deritashëm Alim Rama. Pastaj, anëtari i ri z. Krasniqi, me një fjalë të shkurtër rasti tha se shpreson të punoj në të mirë të institucionit dhe rolit të institucionit, gjithnjë në përbashkësi me anëtarët e tjerë dh, në shërbim të misionit të KQZ.

**Kryetari Radoniqi**, vazhdoi pastaj me pasqyrimin e agjendës së takimit. Mungojnë anëtarët: Rifat Krasniq dhe Ibrahim Selmanaj.

**Sami Kurteshi**, i informoi anëtarët rreth përfundimit të punës që lidhet me rregullat zgjedhore dhe se, ato praktikisht, do të jenë të gatshme për mbledhje të ardhshme për miratim.

**Ilir Gashi**, tha se te “aktivitetet e Sekretariatit” nuk ka material të bashkangjitur për raportin, ndërsa **Arianit Elshani**, tha se është dakord me “kompletimet” që lidhen me rregullat, dhe se në parim është për miratimin e tyre. **Čemailj Kurtiš**, pasi përshëndeti ardhjen e anëtarit të ri të KQZ –së, lidhur me rregulluar tha se edhe vetë ka marrë pjesë në hartimin e tyre, mirëpo ai bëri disa vërejtje rreth përdorimit të shenjave gjuhësore te “nenet”, “paragrafët” etj.

**Sami Kurteshi**, tha se le të rishikohet edhe kjo çështje që po thotë Kurteshi, por le të bëhet edhe korigjimet e tjera...

**Kreshnik Radoniqi** tha se, e lëmë për mbledhjen e ardhshme dhe të merren parasysh edhe vërejtjet që u bënë këtu...

**Burim Ahmetaj**, duke përshëndetur ardhjen e anëtarit Alban Krasniqi, kërkoi që KQZ të shoh se në cilët këshilla të vendoset ai...

**Kreshnik Radoniqi**, kërkoi që të hyjë në rend të ditës pika e “Caktimit të z. Alban Krasniqi në këshillat e KQZ” në këshillat e KQZ-së, dhe të largohet pika 5: “Shqyrtimi dhe miratimi i rregullave zgjedhore” të lihet për mbledhjen e ardhshme...

Pas kësaj, me 9 vota për u miratua rendi i ditës.

Në vazhdim, anëtarët e miratuan procesverbalin e mbledhjes 04/2023 të KQZ. Me 8 vota për, 1 abstenim (Alban Krasniqi), miratohet.

## 2. Shqyrtimi dhe caktimi i anëtarit të ri të KQZ-së z. Alban Krasniqi në këshillat e KQZ:

**Kreshnik Radoniqi**, tha se anëtari paraprak z. Alim Rama, ka qenë kryesues i këshillit për Personel, zëvendës kryesues i KOZ-it, dhe anëtarë i këshillit për Buxhet.

Në kontekst, anëtarët e KQZ-së, vendosen që i njëjti, Krasniqi në këshilla të kooptohet sipas përgjegjësive që i ka pasur anëtari paraprak, Alim Rama.

Me 8 vota për, anëtarët e KQZ-së miratuan caktimin e Alban Krasniqit: Kryesues i këshillit për Personel, Zëvendës kryesues i KOZ-it, dhe Anëtarë i këshillit për Buxhet.

## 3. Aktivitetet e SKQZ-së:

**Burim Ahmetaj**, tha se ky raport është vazhdimësi e punës kontinutive të Sekretariatit. Andaj, në lidhje me planin Strategjik, KQZ është duke vazhduar punën për hartimin e strategjisë së KQZ-së 2023-2026. Deri me tani janë hartuar Misioni, Vizioni, parimet orientuese, analiza SËOT, shtyllat dhe synimet strategjike, ndërsa në punëtorinë e KQZ-së e cila është mbajtur nga data 12-16 shkurt për hartimin e strategjisë, janë hartuar veprimet strategjike, objektivat dhe aktivitetet. Dokumenti i hartuar gjatë punëtorisë (excel) do të bashkëngjitet dokumentit final (ëord).

Dokumenti është dërguar në përkthim në gjuhën serbe dhe do të përkthehet edhe në gjuhën angleze. Deri në finalizim të strategjisë kanë mbetur edhe përcaktimi i përgjegjësive, afateve kohore, resurseve dhe plani i monitorimit. Dokumenti është shpërndarë tek të gjithë zyrtarët për tu plotësuar me indikatorët dhe informatat tjera që kërkohen. Me 02 mars 2023 do të ketë takim me nëngrupin punues dhe përgjegjësit, kur edhe do të shqyrtohen indikatorët dhe plani i monitorimit.

Ahmetaj, më tutje i njoftoi anëtarët me procesin e regjistrimit të pasurisë jo financiare për vitin 2022 është kompletuar në muajin janar 2023 dhe Sekretariati është në fazën e vlerësimit të pasurisë jo financiare të KQZ-së. Në lidhje me tjetërsimin e pasurisë jo financiare përmes shitjes, për disa artikuj para inicimit të procedurës së shitjes, duke siguruar respektimin e procedurave të vendimmarrjes të parapara me Udhëzimin Administrativ për Menaxhimin e Pasurive Jo financiare të KQZ-së, jemi konsultuar edhe me Ministrinë e Financave dhe Transfere në mënyrë që të bëhet publikimi i shpalljes.

Për publikim përmes shitjes Komisioni është bazuar në të dhënat e pranuar nga Komisioni i Vlerësimit përkatësisht raportit të protokoluar nga ky Komision me datë 06.04.2022. Duke i referuar praktikave të Institucioneve tjera, për këtë poçes, Komisioni ka marrë për bazë njoftimet për shitje nga eprokurimi të

institucioneve sikurse janë Dogana e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, KOSTT, Posta e Kosovës, për përcaktimin e njësisë për shitje dhe çmimit minimal.

Po ashtu sipas procedurave në fuqi, gjatë regjistrimit të aseteve dhe vlerësimit në vitet paraprake një pjesë e pajisjeve kapitale janë evidentuar si pajisje të cilat janë jashtë përdorimit dhe kanë vlerën zero në regjistrin kontabël. Andaj, me qëllim të lirimit nga këto asete, pasi që vetëm krijojnë shpenzime për ruajtje dhe nuk janë te nevojshëm për institucionin, bazuar në rregullativën në fuqi për tjetërsimin e pasurisë jo financiare, nga Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve kemi kërkuar aprovimin (në përputhje me UA) për shitjen përmes procedurave të ankandit për një pjesë të aseteve të cilat konsiderohen kapitale sikurse parashihet me Ligjin për Prokurimin Publik.

Një çështje tjetër në raport, u diskutua lidhur me ngritjen e kapaciteteve të stafit të KQZ-së. Në kuadër të planit të punës së KQZ-së, tha Ahmetaj, ky është aktiviteti nr. 15, ngritja e kapaciteteve të stafit të KQZ-së, që ka për qëllim ngritjen e kapacitetit të stafit. Aktiviteti është duke u zhvilluar dhe për fazën e vlerësimit aktiviteti “intervistat me Zyrtaret e qendrës ne Sekretariat” është kompletuar dhe në proces është aktiviteti “Intervistat me ZLKZ”.

Në vazhdim, Kryeshefi Ahmetaj e informoi KQZ-në se nga data 12.09.2022 kur është mbajtur takimi i parë i Këshillit Mbikëqyrës nga KQZ së bashku me OSBE dhe përfaqësuesit e Operatorit Ekonomik (OE), janë mbajtur me shumë se 11 takime të përbashkëta për qartësimin e kërkesave teknike dhe funksionale. Konform planit kohor, janë përfunduar fazat si analiza e kërkesave dhe aprovimi i specifikimeve teknike dhe funksionale. Aktualisht, OE është në fazën e zhvillimit.

Në ditët në vijim, tha z. Ahmetaj, zyrtarë e TI-së të Sekretariatit do të ndjekin nga afër procesin e zhvillimit për tu familjarizuar me shumë me qëllim të mirëmbajtjes me të lehtë.

Lidhur me këto çështje, Ahmetaj në emër të Sekretariatit i rekomandoi KQZ-së që Këshilli Mbikëqyrës të plotësohet edhe me anëtarë tjerë nga Sekretariati, pastaj të bëjë zbatimin e anëtarit të KQZ-së me një anëtarë tjetër, dhe të bëjë plotësimin me zyrtarë nga Sekretariati me Kryeshefin EKzekutiv, Zyrtarin e Lartë për Dizajn dhe Ueb (Visar Kastrati), dhe Zyrtarin e Lartë të Shërbimit votues (Lirik Krasniqi).

Në fund, anëtarët e KQZ e shqyrtuan më tej raportin, qoftë në analizë të raportit dhe qoftë duke shtruar pyetje: Arianit Elshani, Alban Krasniqi i cili, kërkoi që t' barten ato “detyra dhe përgjegjësi” aty ku ka qenë z. Rama.

Me 9 vota për, Këshilli Mbikëqyrës për Softverin e QNR-së, u konstituua me: Alban Krasniqi, Burim Ahmetaj, Visar Kastrati dhe Lirik Krasniqi.

**Fazli Stollaj**, pyeti rreth konkurrit për KKZ-të e komunave veriore pas dorëheqjeve të tyre se, ku qëndron çështja tani, si është gjendja...?

Në këtë pyetje, informoi Burim Ahmetaj tha se, konkursi është shpallur njëherë por s'ka pasur interesim, dhe tani është i shpallur për të dytën herë konkursi dhe se, presim si do të vëjë puna...

Në këtë pikë, diskutuan pastaj: Sami Hamiti, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Gordana Llaban.

#### **4. Aktivitetet e ZRCKFSP:**

Raport për azhurnimet vjetore të partive politike të regjistruara, 31 janar 2023:

**Besnik Buzhala**, tha se ua kemi dërguar raportin e azhurnimeve vjetore të partive politike të regjistruara, 31 janar 2023. Ai, shpjegoi gjendjen e raportit, numrin e partive që kanë dorëzuar me kohë azhurnime, partitë të cilët nuk i kanë dërguar me kohë (janë tri parti), si dhe sanksionet që sipas ligjit ndërmerren me këtë rast.

Raporti, përmban tri shtojca plotësuese. Përgjegjësi e komisionit, është shqiptimi i gjobave.

**Ilir Gashi**, diskutoi rreth gjendjes së subjektit lista “Guxo”, e cila ka zgjedhur dy kryetar në kuvendin e shtatorit të vitit të kaluar. Si këshill, ne kemi kërkuar që Zyra të sjellë rekomandim të qartë rreth kësaj. Rekomandimi, nuk ka ardhur asnjëherë, prandaj zyra nuk mund ta kryej “punën e KQZ-së”, sepse ne nuk jemi të informuar...

Po e shoh që, ky subjekt ka sjellë azhurnim, kurse çështja nuk është trajtuar deri më sot rreth këtij subjekti...

**Besnik Buzhala**, tha se ky subjekt me raportin e azhurnimit e ka dorëzuar me 27 janar 2023, ku në formular është emri i kryetarit: Faton Peci. Para meje, më është thënë se ky subjekt ka merr vendim me mbajt një kuvend, por më nuk kam informata...mirëpo në formularë, kryetar i deklaruar është Faton Peci...

Në këtë pikë, diskutuan: Sami Hamiti, i cili tha të bëhet një raport megjithëse statuti nuk është në harmoni me rregullat tona, por e diskutojmë në mbledhjen e ardhshme. Sami Kurteshi, tha se ne na duhet për KQZ një person si kryetar...

**Arianit Elshani**, tha se kemi një emër specifik por, ne duhet të kemi një standard – një format dhe se, disa subjekte në formularë nuk japin të dhëna të plota, prandaj kërkon plotësimet...

**Ilir Gashi**, tha shkurt: na sillni raportin në mbledhjen e ardhshme...

Në fund, anëtarët e KQZ –së me 9 vota për, shqiptuan gjobë në vlerë prej 300 euro për:

- 1.Stranka Demokratska Akcije (SDA).
2. Lëvizja “Vatra”.
3. Partia Demokratike e Unitetit.

#### **5.Raportet e Këshillave të KQZ-së**

##### **1.Këshilli për Operacione Zgjedhore**

Shqyrtimi dhe miratimi i Projektit dhe Agjendës për “Punëtori në mes zyrtarëve komunal të zgjedhjeve dhe KQZ-së për planin e punës së KQZ-së për vitin 2023 dhe zbatimin e tij:

**Arianit Elshani**, e shpjegoi kërkesën e Sekretariatit për mbajtjen e një punëtorie, si dhe hapat që duhet ndërmarrë rreth organizimit etj. Kjo punëtori, financohet nga OSBE.

**Burim Ahmetaj** tha se, kjo punëtori ishte e planifikuar të mbahet sot, mirëpo për shkak të takimit të KQZ-së, kemi menduar të mbahet me 9 mars 2023.

Anëtarët e KQZ me 9 vota për miratuan projektin dhe agjendën e kësaj punëtore

#### Shqyrtimi dhe miratimi i listës së Qendrave të Votimit:

**Arianit Elshani**, tha se KOZ ka shqyrtuar rekomandimin e Sekretariatit për miratimin e listës së Qendrave të Votimit. Ne, e kemi shqyrtuar në detaje këtë rekomandim tha z. Elshani, kështu që miratimi i hap mundësinë secilit qytetar që të ndryshoj qendrën e votimit jashtë periudhës zgjedhore, brenda komunës ku banon. Për më tepër, nga 904 QV, disa dhjetëra prej tyre janë të reja – krijohen për herë të parë...

Në këtë pikë, diskutuan: Burim Ahmetaj, Alban Krasniqi, Arianit Elshani.

Anëtarët e KQZ me 8 vota për miratuan këtë rekomandim.

#### Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave për distinktiv ID-Bexha:

**Arianit Elshani**, në vazhdim të raportimeve të tij nga DOZ-i, tha se KOZ ka shqyrtuar edhe specifikat për distinktiv ID-Bexha. Specifikat janë reja, të avancuara dhe me kosto më të ulët...

Rekomandojmë miratimin e tyre.

Në këtë pikë, diskutuan: Sami Kurteshi, i cili diskutoi mundësin nëse këto ID të prodhohen nga KQZ. **Alban Krasniqi**, diskutoi rreth kësaj çështje ku kujtoi se dikur është diskutuar që KQZ vetë ti prodhoj disnjektivat... dhe pastaj, kërkoi që procedurat të standardizohet më mirë se sa të lehtësohen, kjo për shkak të aspekteve teknike, identifikimit, specifikave etj.

Heqja e fotografisë në bexh, nuk duhet të bëhet dhe unë nuk e votoj, madje ju ftoj edhe ju të mos e votoni...! Integrimi i zgjedhjeve, është në pyetje...

**Sami Hamiti**: Sa di unë, edhe në të kaluarën foto nuk kanë pas mirëpo, janë të lidhur me identitetin e letërnjoftimeve... Ndërsa, prodhimin mund ta fusim në plan të ardhshëm... Nuk mendoj që, edhe me këto specifika dëmtohet procesi...

**Arianit Elshani** tha se, me të drejtë Albani i ngriti çështjet, por ne i kemi diskutua çështjet sepse në përgjithësi, procesin tani e kemi të digjitalizuar...Janë marrë masa edhe rreth kodit...pra, metodat verifikuese janë të përfshira, në fakt të analizuara...

**Burim Ahmetaj**, tha se çështja e prodhimit nga ne, do të shihet për të ardhmen...duke shqyrtuar edhe kodin, administrimin në përgjithësi të procesit...

**Ilir Gashi**, tha se kemi pasur probleme me bexha për shkak të numrit të madh të vëzhguesve, dhe plus rreziku i ngatërimit të tyre nga një subjekt në tjetrin....

Diskutuan më tej: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Arianit Elshani i cili, në fund propozoi që të tërhiqet kjo pikë dhe të shqyrtohet edhe njëherë dhe, të silllet pastaj në KQZ..

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit mbi realizimin e projektit Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinj për Zgjedhje:

**Arianit Elshani**, tha se KOZ ka pranuar një projekt për Edukimi i Votuesve të Rinj për Zgjedhje në periudhën e fund vitit të kaluar 2022. Ai tha se ndryshe nga e kaluara, projekti është mbajtur në shkolla në 30 komuna. Kanë marrë pjesë 12 315 maturant, të cilëve u është shpjeguar procesi zgjedhor...

Raporti ka të gjeturat – rekomandimet, dhe në fund KOZ rekomandon për aprovim.

Diskutuan: Sami Hamiti, Alban Krasniqi, Sami Kurteshi,

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për miratimin e këtij raporti ?

Me 9 vota për, miratohet raporti i projektit për Informimin dhe Edukimin e Votuesve të Rinj për Zgjedhje

## **2.Këshilli për Buxhet dhe Financa**

Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të planit të buxhetit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Laposaviq dhe Zveçan dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave Zveçan dhe Laposaviq 23 prill 2023:

**Gordana Llaban:** Sot, kemi mbajtur takim të KBF-së, dhe e kemi shqyrtuar buxhetin për zgjedhjet e jashtëzakonshme që do të mbahen për Kryetar të Komunave Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Laposaviq dhe Zveçan dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave Zveçan dhe Laposaviq që duhet të mbahen më 23 prill 2023.

Ne, inromoi znj. Llabani, siç dihet, i kishim ndërprerë të gjitha aktivitetet e këtyre zgjedhjeve, por pas caktimit të tyre KQZ ka bërë planin e buxhetit, dhe ka ndarë 246, 300 euro.

Planifikimi i këtij buxheti për këto zgjedhje, është bërë mbi bazë të planifikimit të zgjedhjeve, kërkesave për zvogëlim të zyrtarëve etj. Pra, buxheti është ribalancu dhe në tërësi, prandaj me rishikimi e ri, buxheti i tërësishëm për këto zgjedhje do të jetë 497, 398 euro.

KOZ rekomandon që ky buxhet, të aprovohet.

**Sami Hamiti**, tha se është analizue buxheti për këto zgjedhje dhe, është zvogëlue për rreth 50 mijë euro. Në përgjithësi, ky plan ka elemente të mira dhe në parim, aprovohet...

Në këtë pikë, diskutuan: Alban Krasniqi, Sami Hamiti, Besnik Buzhala,

**Me vërejtjet e dhëna, me 8 vota për miratohet ky plan**

## **3.Këshilli për personel**

Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të planit të angazhimit të stafit jo permanent për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Laposaviq dhe Zveçan dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave Zveçan dhe Laposaviq 23 prill 2023:

**Arianit Elshani**, tha se këshilli e ka bërë rishikimin e planit të angazhimit të stafit jo permanent për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave Zveçan dhe Leposaviq 23 prill 2023. Është thënë se ka pasur numër të madh të stafit jo permanent, dhe është kërkuar që të shqyrtohet numri i stafit jo permanent, dhe kjo është bërë....!

Do të ketë, 17 zyrtarë më pak të angazhuar në kuadër të SKQZ, KQZ dhe QNR, tha z. Elshani dhe se si këshill, rekomandojmë për aprovim.

Me 8 vota për, miratohet...

## **6. Të ndryshme !**

**Burim Ahmetaj**, tha se është një "Buletin" që e ka dërguar AËB, dhe se u është përcjellë... Janë disa njoftime nga organizatat e ndryshme...! Mirëpo, është edhe një kërkesë për pagesën e anëtarësisë prej 10 000 euro. Kjo, do të na duhet ta bëjmë...

**Kreshnik Radoniqi**: Zyra është duke punuar me UNDP -a për hartimin e akteve nënligjore që kanë të bëjnë me sistematizimin e vendeve të brendshme të punës në zyrë...të akteve nënligjore që kanë të bëjnë me financimin e partive politike, si dhe me softverin...

**Besnik Buzhala**, shpjegoi më shumë rreth bashkëpunimit me UNDP-an...

Diskutuan, edhe: Arianit Elshani, Sami Hamiti, Besnik Buzhala, Burim Ahmetaj, Fazli Stollaj, Kreshnik Radoniqi, Sami Kurteshi i cili, bëri vërejtje rreth njërit prej konkurseve të realizuara në Sekretariat, si dhe vërejtje rreth menaxhimit të stafit jo permanent....